



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 16/06), dhe në lidhje me nenin 44 paragrafi 2 të Ligji për Qarkullim Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59 / 12, 166/12, 170/13, 153/15 dhe 199/15), Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M

për mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/16)

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Ky vendim përcakton mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, si dhe procedurën për marrjen e masave për largimin e parregullsive në funksionimin e sistemeve të pagesave nga ana e Bankës Popullore të Republikës Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

Si parregullsi në aspektin e këtij vendimi nënkuptohen aktivitetet dhe mënyrat e punës së sistemeve të pagesave të cilat nuk përputhen me standardet e përcaktuara të Bankës Popullore (në tekstin e mëtejshëm: principet), me çka pengohet funksionimin i tyre efektiv, i vazhdueshëm dhe i sigurt.

II. Subjekti i mbikëqyrjes

2. Sybjekt i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi janë sistemet e pagesave të përcaktuara me Ligji për Qarkullim Pagesor.

III. Mënyra kryerjes së mbikëqyrjes

3. Banka Popullore kryen mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave si më poshtë:
- Drejtpërdrejt, me një kontroll të operatorit i cili menaxhon dhe udhëheq sistemin e pagesave; dhe
- Indirek, përmes mbikëqyrjes së rregullt nga jashtë të punës së sistemit të pagesave.

4. Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e sistemeve të pagesave mund të jetë:
- e pjesërisht, për të vlerësuar përputhshmërinë e sistemit të pagesave me një apo më shumë principe; dhe
- e plotë, për të vlerësuar përputhshmërinë e sistemit të pagesave me të gjitha principet që duhet të përmbushen varësisht nga kategoria në të cilën është klasifikuar.

5. Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e sistemit të pagesave kryhet në bazë të një vendimi nga guvernatori i Bankës Popullore, me të cilin përcaktohet lënda dhe lloji i mbikëqyrjes dhe personat e autorizuar për mbikëqyrje.

6. Operatori i sistemit të pagesave (në tekstin e mëtejshëm: operatori) është i detyruar personave të autorizuar për mbikëqyrje t'u mundësojë që mbikëqyrja të kryet pa pengesë, të mundësojë kontrollin e punës dhe në kërkesën e tyre duhet të vëhet në dispozicion apo të dorëzojë gjithë dokumentacionin e kërkuar, të dhënat dhe informacione.

7. Pas përfundimit të mbikëqyrjes, personat e autorizuar përgatisin një raport mbi gjetjet nga mbikëqyrja dhe e dorëzojnë tek operatori.

8. Operatori ka të drejtë të ankohet për raportin e pikes së 7 nga ky vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga dita e pranimit të raportit. Ankesa, e verifikuar nga organi mbikëqyrës në një sistem me dy nivele të menaxhimit ose të bordit të drejtorëve në një sistem me një nivel të menaxhimit të operatorit të sistemit të pagesave, dorzohet në Bankën Popullore.

9. Raporti i mbikëqyrjes së kryer konsiderohet i përfunduar 15 ditë pas ditës së pranimit.

Me përjashtim, në rast se operatori paraqet një ankesë, raporti konsiderohet i përfunduar pas dorzimit të përgjigjes nga ana e Bankës Popullore deri tek operatorit.

10. Për zbatimin e mbikëqyrjes indirekte, operatori është i detyruar të dorzojë raporte periodike për punën e tij dhe raporte ad-hoc me kërkesë të Bankës Popullore, si dhe për ndryshimet e planifikuara dhe / ose të zbatuar dhe incidenteve e ndohura që ndikojnë në punën e sistemit të pagesave.

Operatori duhet të dorzojë në Bankën Popullore dhe plan vjetor të aktiviteteve lidhur me testimin e zgjidhjeve të rregullta dhe rezervë dhe procedura dhe plan vjetor për vlerësimin e rrezikut në sistemin e pagesave.

Përmbajtja, forma dhe mënyra e njoftimit nga paragrafet 1 dhe 2 të kësaj pike janë në përputhje me udhëzimin për raportim nga operatorët e sistemeve të pagesave, të cilën e miraton guvernatori i Bankës Popullore.

IV. Metodologjia për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave

11. Për vlerësimin e përputhshmërisë së sistemit të pagesave me principet që janë të detyrueshme në varësi të kategorisë në të cilën është i klasifikuar sistemi i pagesave, operatori për nevojat e mbikëqyrjes është i detyruar që të sigurojë:

- përgjigje të pyetjeve për kërkesat kryesore relevante për vlerësimin e përputhshmërisë së sistemit të pagesave me principin përkatës;
- përshkrim dhe vlerësim të të gjitha ndryshimeve apo reformave që janë në proces ose që parashikohen dhe që do të ndryshonin gjendjen ekzistuese.

Në bazë të informatave, të dhënat dhe dokumentet e marra nga operatori dhe mbikëqyrjes së kryer, në varësi të kategorisë në të cilën është klasifikuar sistemi i

pagesave, Banka Popullore bën vlerësimin e nivelit të përputhshmërisë së sistemit të pagesave me çdo princip, sipas kornizës së mëposhtme për vlerësimin:

Respektohet: sistemi i pagesave respekton principin. Dallimet dhe mospërputhjet e përcaktuara nuk janë çështje problematike dhe janë të vogla, mund të zgjidhen, dhe sistemi i pagesave mund ti trajtojë gjatë veprimit;

Përgjithësisht respektohet: sistemi i pagesave në përgjithësi e respekton principin. Gjatë vlerësimit janë identifikuar një ose disa çështje problematike të cilat sistemi i pagesave duhet të zgjedi dhe ti ndjek në një kornizë të caktuar kohore;

Pjesërisht respektohet: sistemi i pagesave pjesërisht e respekton principin. Gjatë vlerësimit janë identifikuar një ose disa çështje problematike që mund të bëhen serioze nëse nuk zgjidheshin në një kohë të shkurtër. Sistemi i pagesave duhet t'i japë përparësi trajtimit këtyre çështjeve;

Nuk respektohet: sistemi i pagesave nuk e respekton principin. Gjatë vlerësimit janë identifikuar një ose disa çështje problematike që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Sistemi i pagesave duhet të japë prioritet më të lartë zgjidhjes së këtyre çështjeve;

Nuk zbatohet: principi ose disa kërkesat specifike që rrjedhin nga principi nuk zbatohet për sistemin e pagesave i cili është subjekt i vlerësimit, për karakteristikat të veçanta ligjore, institucionale, strukturore apo karakteristikat të tjera të sistemit të pagesave.

12. Kërkesat kryesore dhe pyetje për çdo princip dhe qasja e detajuar e zbatimit me të cilat do të udhëhiqen personat të autorizuar për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave janë të specifikuar në Kornizën për zbardhje dhe metodologjinë për vlerësimin e Komisionit për sistemet e pagesave dhe shlyerjeve në Bankën për shlyerje ndërkombëtar dhe Bordi i organizatës ndërkombëtare të komisioneve të letrave me vlerë.

V. Marrja e masave për largimin e parregullsive në funksionimin e sistemeve të pagesave

13. Nëse me mbikëqyrjen identifikohen parregullsi, Banka Popullore gjatë mbikëqyrjes dhe pas përfundimit të saj, mund të:

- jep rekomandime me shkrim për largimin e tyre deri te organi mbikëqyrës në një sistem me dy nivele të menaxhimit, ose deri te bordi i drejtorëve në një sistem me një nivele të menaxhimit të operatorit dhe përcakton afate për largimin e tyre;
- të kërkojë nga organi mbikëqyrës në një sistem me dy nivele të menaxhimit, ose nga bordi i drejtorëve në një sistem me një nivele të menaxhimit të operatorit, brenda një periudhe të caktuar, të përgatis një plan për të larguar parregullsitë e identifikuar me mbikëqyrjen dhe të njëjtin ta dorëzojë në Bankën Popullore; dhe
- ndërmerr masa të tjera, në përputhje me rregulloret ligjore.

VI. Dispozitat përfundimtare

14. Udhëzimi nga pika 10 paragrafi 3 do të miratohet jo më vonë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

15. Me ditën e zbatimit të këtij vendimi pushon së qeni në fuqi Vendimi mbi mënyrën dhe metodologjinë për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 159/07).

16. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e tetë pas botimit në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", dhe do të zbatohet pas skadimit të 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi.

V. Nr.02-15 / I-7/2016

28 janar 2016

Shkup

**Guvernatori dhe Kryetar Këshilli i Bankës
Popullore të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov**